

## STATUTI I KËSHILLIT TË AKREDITIMIT

### Neni 1 Qëllimi

1. Sistemi i Akreditimit ka për qëllim drejtimin dhe realizimin e procesit të vlerësimit dhe të akreditimit në Shkollat e Larta.
2. Vlerësimi dhe akreditimi i një Shkollë të Lartë Publike ose Jopublike, nuk varet e as nuk përcaktohet nga vetë Shkolla e Lartë.

### Neni 2 Institucionet e Akreditimit

Institucionet e Sistemit të Akreditimit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë janë Këshilli i Akreditimit ("KA") dhe Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë ("AAAL"), që funksionojnë sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

### Neni 3 Këshilli i Akreditimit

1. Këshilli i Akreditimit është organ kolegjal dhe përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët janë personalitete (akademikë, me tituj shkencorë e me përvojë) në fushën e arsimit të lartë, shkencës dhe të ekonomisë shqiptare.
2. Anëtarët e KA emërohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës ("Ministri").
3. Një anëtar i KA-së, mund të shkarkohet nga organi i emërtesës me propozim të Kryetarit të KA, kur ai vepron në kundërshtim me ligjet në fuqi, me Statutin e KA-së, me aktet e tjera të KA-së, si dhe mungon pa arsye në më shumë se tre mbledhje radhazi të KA-së.
4. Kryetari i Këshillit të Akreditimit emërohet nga Kryeministri me propozim të Ministrit. Kryeministri, me propozim të Ministrit, mund të shkarkojë Kryetarin e KA-së, kur ai vepron në kundërshtim me ligjet, me Statutin e KA-së e aktet e tjera të KA-së, si dhe kur mungon paarsye në më shumë se tre mbledhje radhazi të KA-së.

### Neni 4 Kompetencat e Këshillit të Akreditimit

KA ushtron kryesisht këto kompetenca:

1. Shqyrton dhe miraton kriteret e vlerësimit programor dhe institucional të shkollave të larta jouniversitare, universitare dhe pasuniversitare publike dhe jopublike (shkurtimisht "Shkollat e Larta"), të përgatitura e hartuara nga AAAL.
2. Shqyrton dhe miraton paraprakisht Standardet e Cilësisë në Arsimin e Lartë, që përgatiten nga AAAL dhe ja paraqet Ministrit për miratim përfundimtar.

3. Në përputhje me kriteret e vlerësimit, miraton kërkesat e Shkollave të Larta për vlerësime, si dhe kohën gjatë të cilës do të realizohen këto vlerësime.
4. Shqyrton dhe miraton procedurat e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm në Shkollat e Larta, si dhe manualet e udhëzuesit e vlerësimit, që hartohen nga AAAL.
5. Miraton rezultatet e vlerësimeve të kryera nga AAAL në bazë të plotësimit të kriterëve të përcaktuara nga subjekti që vlerësohet dhe vendos për rezultatin përfundimtar të vlerësimeve, duke mbajtur parasysh raportin e përgatitur nga AAAL. Rezultati përfundimtar quhet pozitiv kur plotësohen kriteret e caktuara; në të kundërt quhet negativ. Këtë rezultat KA ia paraqet për vendim Ministrit.
6. KA, në mbështetje të raportit të AAAL-it dhe të rezultateve të vlerësimit të miratuara paraprakisht, a) i propozon Ministrit krijimin, shkrirjen, bashkimin, shpërbërjen, ndryshimin e misionit ose ndryshimin e statusit të një Shkollë të Lartë Publike, ose të strukturave të saj të veçanta.
  - b) rekomandon, vetëm pas përfundimit të procedurave të vlerësimit dhe akreditimit, për hapjen ose jo të një kursi të ri studimi, për mosnjohjen e kurseve ekzistuese të studimit ose për ndryshimin e një kursi studimi ekzistues;
  - c) rekomandon, nëse raporti është negativ, mosnjohjen e kurseve ekzistuese të studimit në arsimin e Lartë jopublik
  - d) rekomandon, vetëm pas përfundimit të procedurave të vlerësimit dhe akreditimit, për hapjen ose jo të departamenteve dhe seksioneve të reja në Shkollat e Larta Publike;
  - e) rekomandon për financimin e Shkollave të Larta Publike bazuar në rezultatet e vlerësimit dhe akreditimit periodik të tyre;
  - f) bën njohjen, përmes procesit të vlerësimit dhe akreditimit, të kursit të studimit dhe të Shkollave të Larta Jopublike, pas marrjes së lejes së hapjes së kursit të Shkollës së Lartë, dhe para përfundimit të kursit të studimit apo të Shkollës së Lartë;
  - g) kërkon tërheqjen e lejes për Shkollën e Lartë Jopublike kur, pas përfundimit të procesit të vlerësimit e akreditimit, vendoset mosakreditimi i kursit të studimit dhe i Shkollës së Lartë.
7. Me propozim të AAAL, KA miraton rendin e vlerësimeve periodike për Shkollat e Larta Publike dhe Jopublike, brenda afatit kohor prej 4 vjetësh.
8. Për realizimin e procesit të vlerësimit dhe të akreditimit, KA ka të drejtë të kërkojë të dhëna e dokumente të mëtejshme nga AAAL, nga Shkolla e Lartë që është në vlerësim dhe nga çdo institucion që zotëron informacione për Shkollën e Lartë dhe që ndihmon për marrjen e një vendimi sa më të drejtë.

9. Për Shkollat e Larta Publike, KA miraton publikimin ose jo të rezultateve për çdo vlerësim, natyrën dhe mjetin e informacionit, ndërsa për Shkollat e Larta Jopublike, KA miraton vetëm natyrën dhe mjetin e informacionit.
10. KA dhe AAAL e botojnë informacionin e mësipërm në një botim vjetor që del në 4 mujorin e parë të vitit pasardhës.

### Neni 5 Mbledhjet e Këshillit të Akreditimit

1. KA mbledhet me kërkesë të Kryetarit, të AAAL, si dhe kur e kërkojnë një e treta e anëtarëve të KA. KA mund të mbledhet edhe kur një gjë të tillë e kërkon Ministri.
2. KA mbledhet të paktën 6 herë në vit.
3. Në mbledhjen e saj të parë KA zgjedh një nënkryetar.
4. Mbledhjet e KA drejtohen nga Kryetari i KA dhe në mungesë të Kryetarit nga nënkryetari i KA.
5. Mbledhjet KA janë të vlefshme kur në to marrin pjesë të paktën dy të tretat e anëtarëve të KA.
6. Mbledhja e KA nuk zhvillohet nëse nuk merr pjesë në të Kryetari i KA ose, në mungesë të tij, nënkryetari i KA-së.
7. KA mund të kërkojë, kur e konsideron të nevojshme për marrjen e një vendimi vlerësimi ose akreditimi, të marrin pjesë në mbledhje përfaqësues të subjektit në vlerësim, të ekspertëve, që kanë kryer vlerësimin e subjektit, ose të ekspertëve të tjerë të jashtëm ose të brendshëm.
8. Me propozim të AAAL-së, në fillim të çdo mbledhjeje KA miraton rendin e saj të ditës, e cila i është shpërndarë paraprakisht të gjithë anëtarëve të KA-së.
9. Në mbledhjet e KA merr pjesë drejtuesi i AAAL, si dhe, kur është e nevojshme, edhe përfaqësues a ekspertë të tjerë të AAAL-së, si dhe persona të tjerë që mund të thirren nga Kryetari i KA-së.
10. Në çdo mbledhje të KA mbahet procesverbal, i cili firmoset nga Kryetari i KA si dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Anëtarët e KA-së kanë të drejtë të bëjnë verifikime në çdo kohë në procesverbal, si dhe të kërkojnë të bëhen ndregje të përmbajtjes së procesverbalit kur janë bërë gabime ose nuk janë pasqyruar si duhet thëniet e folësve në mbledhjet e KA-së.
11. Çdo anëtar i KA, përfshirë Kryetarin, kanë të drejtën e një vote, me përjashtim të rastit kur numri i votave pro dhe kundër është i barabartë. Në këtë rast, vota e Kryetarit është e barabartë me dy vota.
12. Votimi për marrjen e vendimeve të KA bëhet i hapur, me përjashtim të rasteve kur vetë KA me dy të tretat e votave vendos që votimi për marrjen e një vendimi të bëhet i fshehtë.

13. Vendimet e KA-së merren më shumicën e anëtarëve të pranishëm.
14. Vendimi i KA-së firmoset nga të gjithë anëtarët, pavarësisht nga qëndrimet kundër të anëtarëve në pakicë.

### Neni 6 Kryetari i Këshillit të Akreditimit

Kryetari i KA ushtron kryesisht këto kompetenca:

1. Përfaqëson KA në të gjitha aktivitetet që lidhen me vlerësimin dhe akreditimin;
2. Siguron dhe përgjigjet për funksionimin e KA në bazë të ligjeve në fuqi si dhe të Statutit të KA;
3. Siguron dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve të KA-së dhe të akteve normative të Ministrit.
4. Mund t'i propozojë Ministrit ndryshimin e pjesshëm të përbërjes së KA ose largimin e një anëtar i KA-së.
5. T'i delegojë përkohësisht një pjesë ose të gjitha kompetencat e tij nënkryetarit.
6. Mban marrëdhënie të vazhdueshme me AAAL-në.
7. Ka të drejtë t'i kërkojë anëtarëve të KA-së të kryejnë detyra në lidhje me procesin e vlerësimit dhe akreditimit.
8. I paraqet Ministrit raportime të KA-së në lidhje me aktivitetet e kryera prej saj dhe prej AAAL-së.

### Neni 7 Anëtar i Këshillit të Akreditimit

Anëtar i KA-së ka të drejtë kryesisht:

1. Të marrë pjesë në mbledhjet e KA-së.
2. Të diskutojë, të propozojë, të pyesë, të kërkojë shpjegime, si dhe të kryejë edhe veprime të tjera që janë të domosdoshme dhe të nevojshme për trajtimin dhe sqarimin e çështjeve që janë për shqyrtim në KA.
3. Të përmbushë detyrat që i ngarkohen nga Statuti i KA-së, si dhe detyrat e tjera që i caktohen nga Kryetari, ose nga Rregullorja e KA-së.
4. Mban lidhje me AAAL-në.

### Neni 8 Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Akreditimit

1. Kryetari dhe anëtarët e KA shpërblehen sipas legjislacionit në fuqi.
2. Kryetari dhe anëtarët nuk shpërblehen kur nuk marrin pjesë paarsye në mbledhjet e KA-së. Shpërblimi rifillon në mbledhjen vijuese, në të cilën anëtar i është i pranishëm.

Ky statut është miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në VKM Nr.303, datë 1.7.1999 "Për Krijimin e Sistemit të Akreditimit në Arsimin e Lartë"

KËSHILLI  
I AKREDITIMIT